

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

Fakulteti Juridik

Programi i Studimit Juridik i Përgjithshëm LLB

Emërtimi i programit të studimit	Juridik i Përgjithshëm LLB
Grada shkencore:	LLB Baçelor i Drejtësisë
Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve:	Niveli gjashtë -VI- sipas KKK-së
Kohëzgjatja minimale e studimeve dhe numri i ECTS kredive:	Studime katër (4) vjeçare; 240 ECTS kredi
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi i studimit Juridik i përgjithshëm ka për qëllim edukimin dhe profesionalizimin adekuat të gjeneratave të reja të juristëve të Kosovës, duke iu ofruar njohuri, përvoja dhe zhvillim të aftësive analitike, teorike dhe praktike dhe shkathtësive të domosdoshme për ushtrimin e profesionit të juristit në praktikë. Objektivat e këtij programi janë: - T'i realizojë nevojat e të gjithë atyre që mendojnë ta vazhdojnë karrierën e vet në fushën e shkencave juridike. - Të ofrojë njohuri dhe aftësi në lidhje me institucionet dhe bazat e së drejtës pozitive të Republikës Kosovës. - Të sigurojë njohuri themelore të konceptioneve dhe parimeve themelore të së drejtës pozitive të Republikës së Kosovës dhe mënyrës së funksionimit të saj në kontekst ndërkombëtar. - Të zhvillojë një kritikë të ndërgjegjshme të së drejtës në kontekstin komparativ, historik, socio-ekonomik dhe politik dhe t'u ofrojë studentëve një varg konceptimesh të ndryshme teorike të ndërlidhura me studimet juridike. - T'u mundësojë studentëve që të qëndrojnë dhe të studiojnë jashtë vendit brenda suazave të programeve për shkëmbimin e studentëve. - T'u ofrojë një sërë opsionesh, që do tu mundësojnë studentëve të studiojnë fushat specifike të së drejtës. - T'u mundësojë studentëve të jenë pjesë e

	veprimtarisë hulumtuese në kuadër të studimeve të tyre. - Të ofrojë mundësi për zhvillimin e aftësive personale, komunikimin, hulumtimin dhe aftësi të tjera të rëndësishme të nevojshme për punësimin e të diplomuarve në institucionet e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. - Studentët e diplomuar, do të jenë në gjendje t'i identifikojnë çështjet juridike që duhet të hulumtohen, do t'i përdorin në mënyrë efikase burimet primare dhe sekondare të së drejtës, ta hulumtojnë shkencën juridike, t'i vlerësojnë në mënyrë kritike çështjet juridike, si në aspektin e doktrinës, ashtu dhe në aspektin praktik - implementues.
Rezultatet e pritshme të mësimit:	Njohuritë dhe të kuptuarit - Të fitojnë njohuri themelore të shkencës juridike dhe mënyrës së krijimit të së drejtës, të zhvillohet dhe të ndryshohet përvoja e tyre duke përfshirë edhe burimet edhe institucionet e së drejtës në kontekstin e tyre më të gjerë; - Të fitojnë njohuri nga degët më të rëndësishme të së drejtës, siç janë: e drejta kushtetuese dhe administrative, e drejta civile, e drejta e punës, e drejta penale, procedura civile dhe penale, si dhe e drejta ndërkombëtare publike dhe private; - Të fitojnë njohuri në lidhje me strukturën, përmbajtjen dhe funksionimin e sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe marrëdhëniet e tij me të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane; - Ta njohin kontekstin social-ekonomik dhe historik në të cilin veprojnë normat juridike. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit - I identifikon dhe aplikon parimet dhe rregullat themelore në fusha të caktuara, sikurse janë: e drejta administrative dhe kushtetuese, e drejta civile, e drejta e punës, e drejta penale, procedura civile dhe penale, dhe e drejta ndërkombëtare publike dhe private; - I identifikon problemet juridike që mund të paraqiten në situata të ndryshme faktike dhe propozon zgjidhje për to; - Përdor metoda shkencore për të krijuar një

	punim hulumtues në disa degë të së drejtës. Aftësitë për të vlerësuar - Identifikon, shpjegon, analizon dhe zgjidh probleme juridike në mënyrë që pritet nga një jurist i ri; - Interpreteton dhe e sintetizon kuptimin e normave juridike si pjesë e sistemit ligjor dhe e aplikon në situata të shumta që mund të ndodhin në jetën e përditshme; - I vlerëson në mënyrë kritike normat ekzistuese juridike dhe etike me të cilat rregullohet profesioni juridik. Aftësitë e komunikimit - Komunikon në mënyrë efektive me gojë dhe me shkrim me subjekte publike dhe private; - Shkruan dhe redakton në nivel themelor dokumente me karakter juridik, siç janë: kërkesa, ankesa, kontrata, testamenti, padia, etj; - Merr iniciativë dhe përgjegjësi për aktivitete individuale dhe grupe përmes së cilave implementohet pjesëmarrja efektive në profesionin e juristit. Aftësitë e të mësuarit - Merr iniciativë dhe përgjegjësi për të identifikuar dhe aplikuar nevojat e mësimit në degët më të rëndësishme të së drejtës; - Zhvillon sistemin e të mësuarit që përfshin identifikimin, klasifikimin, sintetizimin dhe përdor burime të ndryshme; - Ka aftësi të shfrytëzojë bibliotekën për të marrë njohuri juridike; - I shfrytëzon aftësitë kompjuterike për të fituar dituri juridike.
Mësimdhënia dhe mësim nxënia:	Mësimdhënia, mësim nxënia dhe vlerësimi i studentëve (provimet) realizohen në përputhje me planet e punës, orarin e ligjëratave, orarin e provimeve për lëndët, rregulloret përkatëse të përgjithshme të UHZ-së siç janë: Rregullorja për Studime Bachelor, Rregullorja për Studime Master. Gjatë realizimit të programeve të studimit, procedura për monitorimin, kontrollin dhe modernizimin e programeve të studimit zhvillohen sipas Rregullores për Sigurim të

	Cilësisë.
Vlerësimi i studentëve:	Mënyra e vlerësimit të studentëve nga mësimmshënësit parashihet në syllabuset e lëndëve përkatëse dhe komunikohet tek studentët në javën e parë të ligjëratave. Monitorimi i mënyrave të vlerësimit bëhet nga Koordinatori për Sigurim të Cilësisë.